



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.306/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Ymer Hoxha anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Sevil Liman Kazaz kandidate për kuvend komunal në Prizren nga subjekti politik Kosova Turk Demokratik Partisi (KDTP) me seli në Prizren, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 23.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, ashtu që subjekti politik Kosova Turk Demokratik Partisi (KDTP), i shqiptohet dënimi më gjobë në shumë prej 200 (dyqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

Me datën 21.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me të cilën pretendon se Sevil Liman Kazaz kandidate për kuvend komunal në Prizren nga subjekti politik Kosova Turk Demokratik Partisi (KDTP) gjat heshtjes zgjedhore me datën 21 tetor 2017 ka bërë fushatë duke shpërndarë foto në facebookun e tij, në të cilën bënë thirrje për ta votuar numri 9 që mban kandidatja dhe numri 22 të KDTP-së. Parashtruesi i ankesës thekson se këto veprime bien ndesh me nenin 36.1 pika b) të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara në cilësi të provës materiale.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik KDTP thekson se kanë marre masat për largimin e posterit në facebook, ashtu që kandidatja në fjalë ka deklaruar se nuk e ka ditur që është shkelje postimi në facebook dhe se menjëherë ka larguar postimin nga llogaria e vet e facebookut.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 të LZP-së gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës shihet se kandidatja për kuvend komunal në Prizren nga subjekti politik KDTP, Sevil Liman Kazaz gjatë heshtjes zgjedhore në rrjetin e saj social facebook ka bërë fushate zgjedhore dhe ka udhëzuar që të votohet ajo me numër 9 dhe nr 22 i subjektit të saj politik KDTP, ku me këtë veprim ka shkelur Kodim e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit dhe Kandidatet e tyre duke bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Ndersa lidhur me pretendimet e subjektit politik KDTP se kandidatja në fjalë nuk e ka ditur që postimi i bërë është shkelje e heshtjes zgjedhore, Paneli konstaton se këto pretendime nuk qëndrojnë pasi që në bazë të nenit 32 par 3 dhe 4 të LZP-së subjektet politike i informojnë anëtarët, mbështetësit e tyre dhe kandidatët rreth dispozitave të këtij kodi, dhe duhet të ndermarin të gjitha hapat e nevojshme për ti parandaluar nga shkelja e këtij kodi.

Andaj PZAP-i duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se subjekti politik KDTP është përgjegjëse për veprimet e saja duke shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) e LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku parashihet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja fushatë në çfarëdo mënyre.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL Anr.306/2017 më datën 23.10.2017.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.